



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"
PUBLIC UNIVERSITY "KADRI ZEKA"

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

Prof. Dr. Bajram Kosumi
Rektor

FJALIMI I REKTORIT KOSUMI PËR 10 VJETORIN E UKZ

1. Janë bërë dhjetë vite nga themelimi i UKZ, vitet e para, të nisjes, ashtu sikur vitet e nisjes në jetë të fëmijës. Për neve në Kosovë, kjo nuk është pak gjë: asnjëherë në shekujt e kaluar nuk patëm institucionet tona, politike, sociale apo arsimore, në rastet më fatlume patëm institucione surrogate, të cilat nuk i udhëhiqnim vetë, por na dirigjonin. Është hera e parë që ne bëjmë institucione të mëdha, si shteti, qeveria, gjykata, institucion shëndetësor, apo në rastin tonë universitet. Prandaj për neve është çështje e madhe dhjetë vite universitet.

Këta janë dhjetë vitet e themelimit, kur gjithçka fillon pothuajse nga zero. Ata që kanë punuar në ngritjen e institucioneve nga zero e dinë se sa vullneti, sa puna, sa mundi e sa pengesa është në atë rrugë. Por, kjo të bën krenar, sepse sheh çdo ditë ngritjen dhe, kjo ta shton besimin.

2. Sado sot është dita kur mund të tregojmë rezultatet, nuk do ta bëjmë këtë, megjithatë nuk mund të mos përmendim vetëm, disa, sa për të argumentuar suksesin e viteve të themelimit:

- Deri më tash 8242 studentë janë regjistruar në UKZ;
- 1989 studentë kanë diplomuar;
- Përveç studimeve baçelor, UKZ ka disa programe shumë të sukseshme të masterit;
- Nga 4 profesorë me orar të plotë, UKZ ka pranuar mbi 55 profesorë me orar të plotë;
- Nga 7 zyrtarë të administratës sot UKZ ka mbi 33 zyrtarë administrativë;
- UKZ është riakredituar suksesshëm tri herë deri më tash si universitet, ndërsa në të gjitha proceset e akreditimit të programeve studimore kemi dalë të suksesshëm;
- Është krijuar sistemi i sigurimit të cilësisë, që dmth. janë krijuar dokumentet, organet dhe instrumentet për vlerësim, monitorim dhe raportim të cilësisë;
- Me shfaqjen e pandemisë Covid 19 UKZ iu kanë dashur vetëm dy javë që ta ndërrojë gjithë sistemin e mësimit nga ai në klasë në mësim virtual;
- UKZ apo fakultetet e tij janë themelues apo pjesë e 11 forumeve universitare, kombëtare e ndërkombëtare;
- UKZ ka nënshkruar 40 marrëveshje bashkëpunimi me universitete të tjera, 45 marrëveshje bashkëpunimi me bizneset, 11 marrëveshje ICM dhe 11

marrëveshje të tjera, me një total prej 116 marrëveshjeve bashkëpunimi, prej të cilave shumica të aktivizuara dhe të suksesshme;

- UKZ është bashkorganizatore e shumë konferencave shkencore, ndërsa tashmë ka themeluar edhe Konferencën Vjetore të UKZ, e cila sivjet do të organizohet për herë të dytë;
- Stafi akademik i UKZ ka rritur ndjeshëm numrin e publikimeve shkencore dhe pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare, si psh., gjatë vitit 2022 stafi ka marrë pjesë në 44 konferenca shkencore dhe ka publikuar 39 punime në revista ndërkombëtare të indeksuara në Web of Science apo në Scopus.

Unë solla disa fakte e shifra për të treguar diagonalen e lëvizjes së UKZ nga viti 2013 në vitin 2023. Por, çmimin e vërtetë këtij suksesi ia vënë vetë studentët të cilët kanë kaluar nëpër këto salla e laboratore. Po sjell vetëm njërin prej tyre, Besar Rexhepin, i diplomuar ne FSHK:

“Që nga diplomimi në UKZ, në vitin 2019, në Shkenca Kompjuterike, tani e tre vite kam biznesin tim; një byro kreative që në fokus ka krijimin e identitetit vizual, brendit dhe zhvillimin e web-it. Një pjesë e suksesit tim padyshim që i takon UKZ, nga i cili kam marrë hapat dhe njohuritë që sot të kem mundësinë të kontribuoj në shoqëri në njërin prej fushave e cila ka një rëndësi të madhe në shekullin XXI.”

3. Të dashur të pranishëm, tash e hapim faqen tjetër. Këto dhjetë vite janë një kohë e mjaftueshme për të parë dallimin e madh midis asaj që duam të bëjmë dhe mundësisë për të bërë. Nëse dekada e parë është dekada e besimit të madh te universiteti dhe ndërtimi i tij, dekada në të cilën po hyjmë do të jetë dekadë e shkencës në të mirë të publikut. Universiteti i shërben shkencës, por shkenca ka kuptim vetëm kur është në të mirë të njerëzimit. UKZ do të fokusohet në këtë drejtim: të gjenerojë shkencë, pra informata, të dhëna, analiza, përfundime, rekomandime etj., të cilat do të jenë në dobi të shoqërisë, të ekonomisë dhe të sistemeve tona shtetërore.
4. Sot universiteti shikohet me dyshime prej shumëkujt: është krijuar opinioni se cilësia e arsimit universitar është shkaktari i shumë prapambetjeve në Kosovë, i shumë pasojave, i migrimit të popullatës etj. Universiteti shihet si një shkop magjik. Sigurisht universiteti është një faktor vendimtar në zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë, por ai nuk është shkop magjik. Universiteti duhet të përkrahet nga të gjithë ata hisedarë që presin produktin e tij: nga qeveria, nga bizneset dhe nga grupet e tjera të interesit, të cilët duhet të jenë partnerë të besueshëm. Po ashtu, ky investim në universitete nuk është si investimi në asfalt:

rezultati i tij duket pas dhjetë, pesëmbëdhjetë e më shumë viteve. Aktorët seriozë shoqërorë duhet ta planifikojnë këtë rrugë të gjatë bashkë me universitetin.

5. Universiteti publik, gjithmonë e gjithkund, është interes edhe përtej shkencor i shtetit e shoqërisë. Universiteti krijon superstrukturën e shoqërisë. Prandaj Beogradi në vitet '70 të shekullit të kaluar e ka kundërshtuar formimin e Universitetit të Prishtinës. Universiteti i Prishtinës, për disa dekada të shekullit XX e krijoi një klasë të inteligjencies e cila hyri në procesin e çlirimit të Kosovës dhe të shtet ndërtimit. Studentët e atij universiteti, tri herë ndryshuan rrjedhën historike të Kosovës: më 1968, më 1981 dhe më 1997. Kështu, universiteti i Prishtinës u bë «kështjellë e nacionalizmit», si e cilësonte propaganda serbe, në fakt u bë kështjellë e lirisë.

Edhe sot universitetet e Kosovës e vazhdojnë këtë traditë për krijimin e filozofisë së lirisë, shoqërisë së lirë e moderne, krijimin e vlerave të demokracisë, krijimin e mendimit kritik e të njeriut të lirë dhe një kulturë pozitive nacionale e shtetërore. Sulmet që iu bëhen universiteteve publike në kohë të ndryshme, në të vërtetë këtu e fokusojnë cakun e vërtetë të goditjes, pikërisht te kjo kulturë nacionale moderne.

Sot, UKZ, përveç interesit arsimor e shkencor, është edhe interes nacional, në dy aspekte. Së pari, është në trekëndëshin kufitar Kosovë-Serbi-Maqedoni e Veriut, e meqenëse në dy shtetet jeton komuniteti shqiptar, UKZ mund të jetë një pikë ndërlidhëse për ato komunitete. Së dyti, duke qenë rajoni i Gjilanit vend multikultural ndër shekuj, edhe sot, mund të luajë një rol më të madh në integrimet kulturore kosovare dhe rajonale.

6. Duke hyrë në një epokë të re, në epokën virtuale, universiteti duhet të përshtatet dhe të gjejë rolin e vet. Statusi i dijes në epokën e internetit dhe të botës virtuale ka ndërruar dhe po ndërron me shpejtësi të madhe. Kjo e afirmon dijen, por njëkohësisht, krijon mundësi për shpërdorimin e saj. Universiteti është rruga më e sigurt për ruajtjen e statusit të dijes në shërbim të njerëzimit.

Teknologjia informative, si të gjitha mediet, ka dy faqe: anën pozitive dhe negative. Interneti dhe ueb kultura mund të shihet si cak i lartë i zhvillimit për kulturën tonë, por gjithashtu mund të jetë aktdënim. Varet prej njeriut se cilën anë e funksionalizon. Ky njeri del nga dera e universitetit. Ne ende nuk e njohim saktë këtë botë virtuale, nuk e kuptojmë se në çfarë rrugësh do të na fusë, por, se ajo po e ndryshon rrënjësisht shoqërinë, kjo është e sigurt.

Nuk është plotësisht e saktë se Covid 19 e ka ndryshuar shoqërinë, ai vetëm e nxori në sipërfaqe kompjuterin dhe internetin, pra botën virtuale, për të na treguar se shoqëria njerëzore ka edhe zgjidhje alternative ndaj traditës së deritashme organizative të jetës. Shoqëria sot është në rrugën e ndryshimeve rapide. Ajo shoqëria që nuk do të përshtatet me këto ndryshime, do të shuhet.

Prandaj ne duhet të investojmë shumë më tepër në universitete, që të përgatitemi për këto ndryshime, të cilat tashmë kanë filluar.

7. Reformimi i arsimit të lartë është përherë i domosdoshëm, diçka si abdejtimi i programeve softuerike. Ndonjë herë edhe mund të mos abdejtohesh për një kohë të gjatë, por rrezikon. E vetmja gjë që nuk duhet lejuar është reformimi pa vizion, apo abdejtimi pa asnjë qëllim. Fatkeqësisht kjo ka ndodhur në Kosovë disa herë me arsimin, duke filluar me ligjin e parë për arsimin e Lartë (2003). Pa vizion të qartë, sa më shumë të prodhohen ligje, strategji, programe, nisma etj., aq më keq bëhet.

Universitetet nuk kanë arritur ta krijojnë një vizion të qartë për veten e tyre, e as qeveria dhe bizneset nuk e kanë një politikë të qartë për interesat e tyre nga universitetet.

Kjo vazhdon të jetë një çështje të cilën duhet zgjidhur, por një gjë është e qartë: për arsimin e lartë, për universitetet, për shkencën dhe akademinë duhet të flasin e të vendosin vetë ata që janë pjesë e këtyre superstrukturave, dhe jo ndryshe. Kjo mund të mos ju pëlqejë shumë strukturave të tjera sociale, në radhë të parë klasës politike, por në asnjë vend të Europës, nëse i marrim si modele ato, me të drejtë, politika nuk vendos për arsimin e lartë e për shkencën. Prandaj, edhe në rastin tonë, qeveria dhe klasa politike duhet të mbështesë universitetet publike në rrugën e tyre të përparimit.

8. Universiteti është një mundësi e madhe për shoqërinë, me kusht që aty të kultivohet mendimi kritik, të nxitet hulumtimi shkencor, por edhe studentët të përgatiten për tregun e punës. Vetëm me këtë qasje studentët tanë mund t'ia kthejnë borxhin shoqërisë dhe atdheut, e që është: përmirësimi i mirëqenies sociale, zhvillimi ekonomik si dhe promovimi i kulturës sonë e i vlerave të gjithmbarshme kulturore. Vetëm me këtë qasje Universiteti ynë mund ta luajë rolin e dritares së shoqërisë: një dritare e hapur për të parë dhe për të komunikuar më shumë me botën.

9. Universiteti është rruga më e sigurt për të zbutur e zgjidhur dallimet dhe polarizimet e mëdha të botës bashkëkohore, ndër të cilat po përmend:

- identitetet, kulturat, gjuhët dhe shoqëritë e vogla, përballë proceseve globaliste;
- vlerat e demokracisë përballë nevojave njerëzore për një jetë më të mirë;
- vlerat e demokracisë përballë paqes globale;
- konfliktet fetare;
- kultura e konsumatorizmit përballë varfërisë ekstreme;
- kultura e ruajtjes së mjedisit dhe të ajrit përballë shpërdorimit të natyrës e të ajrit;
- digjitalizimi i dijeve dhe rreziku i krijimit të njeriut pa kujtesë ose gjysmanalfabetë;
- jeta virtuale dhe rritja e urrejtjes etj.

10. Universiteti është gjeneratori i multikulturalizmit me njeriun në qendër. Ky është vizioni që na thërret. Bota nuk është unikulturore por multikulturore dhe e tillë duhet të mbetet.

Roli i universitetit, pra edhe i UKZ, në shoqërinë e sotme është më i domosdoshëm se asnjë herë më parë. Shumëkush e sheh atë thjeshtë si një mundësi karriere, por e vërteta është shumë më e thellë: universiteti është rruga më e sigurt e zhvillimit të shoqërisë shqiptare.

Asgjë më shumë se universiteti nuk na bën konkurrent në tregun global, duke e ruajtur vetveten tonë, edhe njeriun edhe kombin. Çdo rrugë tjetër është më e pasigurt dhe e dështuar. Vetëm universiteti dhe nivelet e tjera të shkollimit na bëjnë mendjehapur, pa e zhbërë vetveten. Vetëm universiteti dhe nivelet e tjera të shkollimit, mund ta shtyjnë përpara idealin e Rilindjes Kombëtare, idealin e rilindjes filozofike e kulturore, duke e ndërlidhur me idealet e sotme të dinamizmit teknologjik e të globalizmit.

Ne jemi universitet i ri, për një shoqëri të re, për një shtet të ri, por synimi është shekullor: dija e përdorur në të mirë të njerëzimit e bën njeriun më të lumtur më shumë se çdo vlerë tjetër.

Na priftë e mbara të gjithëve!

Gjilan, më 9.3.2023